



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË ISTOGUT PËR VITIN 2020

Prishtinë, gusht 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkjmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: z. Haki Rugova, Kryetar i Komunës

Adresa: Rr.Fadil Ferati, 31000 Istog, Istog, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Istogut (KI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Istogut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

A1 Komuna nuk ka prezantuar saktë të dhënat në PVF si në vijim:

- Në nenin 14 - Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit - shënimi 11 pranimet nga grandet e përcaktuara të donatorëve ishin mbivlerësuar për 205,000€. Po ashtu, tek shënimi 12 - të hyrat tjera ishin mbivlerësuar për 93,000€; dhe
- Në nenin 16 - Llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar për 1,290,922€;

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Istogut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Istogut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Në tri raste faturat/obligimet në vlerë totale 792,184€ ishin paguar pas afatit kohorë ligjor prej 30 ditësh.
- A3 Komuna kishte ndarë subvencione për "Furnizim me material ndërtimor për sanimin e gjendjes nga fatkeqësitë natyrore" në vlerë 30,250€, pa vendosur kriteret e qarta.
- B1 Në 38 raste qiramarrësit pavarishtë faktit që kishin borxhe të pashlyera (12,040€) ndër vite ndaj komunës ende vazhdojnë të shfrytëzojnë pronat e komunës dhe komuna nuk kishte ndërmarr asnjë veprim ligjor ndaj tyre. Po ashtu borxhet në vlerë 3,960€ të shtatë qiramarrësve ishin shlyer nga lista e borxheve nga zyrtari përgjegjës pa bazë ligjore.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunes është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunes është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Istogut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Istogut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Istogut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Istogut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Istogut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin

transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Prezantim jo i saktë i të dhënave në PVF

Gjetja

Rregullorja MF - nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore përcakton detyrimet e raportimit, mënyrën e raportimit dhe formën e raportimit të organizatave buxhetore sipas Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Komuna nuk ka prezentuar saktë të dhënat në PVF si në vijim:

- Tek neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit-hyrjet e parasë së gatshme - shënimi 11 - grantet e përcaktuara të donatorëve ishin mbivlerësuar për 205,000€, ku të prezantuara në PVF ishin 216,000€, ndërsa sipas shënimeve të thesarit vlera e saktë e tyre ishte 11,000€. Po ashtu, tek shënimi 12 të hyrat tjera ishin mbivlerësuar për 93,000€, ku sipas shënimeve të thesarit vlera e tyre ishte zero.
- Tek neni 16 -Të arkëtueshmet ishin nënvlerësuar për 1,290,922€, pasi që nuk ishin prezentuar fare të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë 1,277,382€ dhe qiraja e tokës komunale me karakter të përkohshëm në vlerë 13,540€.

Shkak i kësaj ishte se ZKF ishte i infektuar me Covid-19 dhe Komuna nuk kishte angazhuar zyrtar alternativ për përgatitjen e Pasqyrave Financiare.

Ndikimi

Paraqitja jo e saktë e informatave në pasqyra financiare shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të komunës dhe ka ndikim negativ në saktësinë e kërkesave të ardhshme buxhetore. Po ashtu, këto mangësi kanë ndikuar që disa llogari të jenë të mbivlerësuarra e disa të jenë të nënvlerësuarra.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të shtojë kontrollet gjatë përgatitjes së PFV në mënyrë që pasqyrat dhe shpalosjet për vitin 2021 të mos përmbajnë gabime. Po ashtu, duhet të sigurohet se deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk nënshkruhet nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PVF-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja

Sipas nenit 39.1 të Ligjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kërkohet që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës.

Në tri raste/fatura ⁵ në vlerë totale prej 792,184€ pagesa e tyre nuk ishte bërë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat variojnë nga 98 deri 128 ditë kalendarike.

Sipas zyrtarëve të komunës, kjo gjendje është krijuar në mungesë të mjeteve buxhetore.

Ndikimi

Vonesat në pagesa mund të ndikojnë në rritjen e obligimeve të cilat krijojnë implikime buxhetore për vitin vijues dhe rrezikojnë të shkaktojnë shpenzime shtesë për shkak të pagesave sipas vendimeve gjyqësore/përmbarrimore.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të vendos kontrolle shtesë për tu siguruar se të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve të paguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Përzgjedhja e përfituesve pa kritereve formale

Gjetja

Sipas nenit 4 paragrafet 2 dhe 3 të Rregullores së Kuvendit Komunal të Istogut për ndarjen e subvencioneve nr.42/2014, -"Pas pranimit të kërkesave Zyra e Kryetarit, drejtoratet përkatëse përgjegjëse për fushat e caktuara, Zyra e Kryetarit dhe Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim i shqyrtojnë kërkesat e parashtruara nga personat fizik dhe personat juridik-jofitimprurës të cekur në nenin 2 të kësaj rregulloreje në afat prej 15 ditëve, dhe i propozojnë Kryetarit të Komunës për marrjen e vendimit. Kryetari i Komunës merr vendim për miratim apo refuzim për përkrahje financiare në afat prej 15 ditëve dhe e cakton shumën të cilën e vlerëson si të arsyeshme për realizimin e aktivitetit të parashtruar më kërkesë apo projekt." Neni 13, paragrafi 3, "Përkrahen financiarisht kërkesat dhe projektet nga fusha e shërbimeve publike, mbrojtje dhe shpëtim, dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore".

Komuna përmes projektit "Furnizim me material ndërtimor për sanimin e gjendjes nga fatkeqësitë natyrore", kishte subvencionuar 28 përfitues në vlerë 30,250€ nga gjithsej 64 aplikues. Mënyra e përzgjedhjes së përfituesve nuk ishte e qartë ngaqë vlerësimi i aplikacioneve ishte bërë në mungesë të kritereve formale, Përzgjedhja ishte bërë sipas vlerësimit të drejtorit të drejtorisë përkatëse i cili edhe kishte nënshkruar vendimin për mbështetjen e këtyre përfituesve përderisa sipas rregullores vendimi është dashur të merret nga ana e kryetarit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Ndarja e subvencioneve në mungesë të kriterëve formale si dhe marrja e vendimeve nga zyrtarët jokompetent rrit rrezikun që vlerësimi të jetë subjektiv dhe që të mos subvencionohen aplikues të cilët janë meritör.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj që gjatë subvencionimit të respektohen rregulloret në fuqi, gjithashtu duhet të inicioj procedura për vendosjen e kriterëve për vlerësimin e kërkesave dhe ndarjen e subvencioneve për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Shfrytëzim i pa rregulltë i pronave komunale

Gjetja Rregullorja nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme, në nenin 4 obligon komunën që dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme ta bëjë përmes procedurës së ankandit publik.

Lidhur me këtë kemi identifikuar se:

- Komuna në vitet paraprake kishte dhënë në shfrytëzim 45 prona me qira me karakter të përkohshëm pa ankand publik. Në kontratat e nënshkruara nuk është përcaktuar kohëzgjatja e shfrytëzimit të pronave.
- Po ashtu gjatë viteve, komuna u kishte dërguar përfituesve njoftime lidhur me mospërbushjen e obligimeve për shfrytëzimin e pronave duke i njoftuar se nëse në afat prej shtatë ditësh nga pranimit i njoftimit nuk përmbushën obligimet do të shkëputen kontratat. Megjithatë, 38 qiramarrës pavarësisht faktit që kishin borxhe të pashlyera (12,040€) ndër vite ndaj komunës ende vazhdojnë të shfrytëzojnë pronat e komunës dhe komuna nuk kishte ndërmarr asnjë veprim ligjor ndaj tyre.
- Borxhet e shtatë qiramarrësve në vlerë 3,960€, ishin shlyer nga lista e borxheve nga zyrtari përkatës pa bazë ligjore.

Shkak i kësaj ishte neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës në përgatitjen e duhur të kontratave dhe keqëpërdorimi i detyrës në shlyerjen e borxheve pa bazë ligjore.

Ndikimi Dhënja në shfrytëzim e pronave pa ankand publik si dhe mos ndërmarrja e veprimeve për mbledhjen e borxheve nga komuna ndikon në dëmtimin e buxhetit të komunës, kurse largimi nga lista i qiramarrësve borxhli pa bazë ligjore përveç që zbeh kredibilitetin e komunës pamundëson edhe marrjen e veprimeve ligjore për mbledhjen e tyre.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe të siguroj se prona komunale ofrohet për shfrytëzim vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave. Gjithashtu, duhet të shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e planifikuara do të realizohen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Çështjet për pasqyrat financiare

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja B2 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 79,501€⁶ në kategori ekonomike jo adekuate. Këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve, të cilat komuna i kishte kryer/paguar 52,213€ nga kategoria e investimeve kapitale, si dhe 27,288€ nga mallrat dhe shërbimet.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrollove të brendshme.

Ndikimi Planifikimi jo i duhur i ndarjeve buxhetore sipas nevojave dhe objektivave që komuna pritet të arrijë ka ndikuar në klasifikim jo adekuat të shpenzimeve dhe prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke ofruar informata të gabuara për lexuesin.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e komunës, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Të hyrat

Komuna për vitin 2020 kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 1,151,298€, nga të cilat ishin realizuar 787,307€ apo 68%. Këto të hyra janë kryesisht nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, veprimtaritë biznesore, qiraja etj. Përveç këtyre të hyrave komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror (gjobat nga policia, gjykata dhe agjensioni i pylltarisë) në vlerë prej 161,459€.

Çështja A4 - Mangësi në bazën e të dhënave për tatimin në pronë

Gjetja

Neni 11 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në pronë të paluajtshme, përcakton që "Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohe zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit", si dhe paragrafi 4 përcakton që "Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim 2 (dy) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitë e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme". Bazuar në kërkesat e sistemit Protax, dosja e tatimpaguesit duhet të përmbajë elementet si në vijim: numrin personal ID, numrin e tatimpaguesit, pronës, ndërtesës, fotografi etj.

Nga mostrat e testuara dhe analiza e bazës së shënimeve të Protax-it, kemi konstatuar se numri i tatimpaguesve që përfitojnë nga zbritja pa e pasur dosjen e kompletuar është 1,237, ku 608 prej tyre nuk kanë të vendosur numrin e letërnjoftimit ndërsa 629 kanë të vendosur numra që nuk korrespondojnë me numër të letërnjoftimit të Republikës së Kosovës.

Shkaku i ndodhjes është neglizhenca e zyrtarëve kompetent për kompletimin e dosjeve të tatimpaguesve.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar në bazën e të dhënave dhe informatat e mangëta në dosjen e tatimpagueseve përfshirë numrin personal, ndikon në mundësin e përfutimit të zbritjes së vendbanimit parësore në më shumë se një pronë.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të siguroj se dosjet e tatimpaguesve janë kompletuar bazuar në kërkesat e sistemit Protax.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 435,063€, prej tyre ishin shpenzuar 315,008€. Komuna kryesisht ka mbështetur aktivitetet kulturore, sportive si dhe ka ndihmuar bujqit, fermerët dhe qytetaret në nevojë. Kemi testuar pesë mostra për teste substanciale në vlerë 58,700€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A5 - Thirrja publike dhe monitorimi i subvencioneve në kundërshtim me rregulloren

Gjetja

Rregullorja MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, neni 13, përcakton kriteret të cilat duhet ti përmbajë 7 thirrja publike si: Formularin 9/projekt-propozimin, Formularin 10/projekt buxhetin, të dhëna për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes etj. Po ashtu, sipas nenit 23.1 të rregullores së njëjtë Monitorimi dhe raportimi i projekteve dhe programeve përcakton se “Për secilën kontratë të lidhur, ofruesi i mbështetjes financiare cakton një zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Ndërsa në pikën 2 kërkohet nga përfituesi të raporton te zyrtari monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit, sipas kërkesave të kontratës.

Lidhur me këtë kemi identifikuar se:

- Thirrja publike për subvencionim të aktiviteteve sportive e datës 02.05.2020 nuk ishte në përputhje me rregulloren pasi që nuk përmbante: Formularin 9/projekt-propozimin, Formularin 10/projekt buxhetin, dhe të dhëna për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes. Tri OJQ nga kjo thirrje janë përzgjedhur dhe kanë përfituar subvencion në shumë prej 14,500€ pa përgatitur projekt propozim, projekt buxhet dhe pa të dhënat për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes. Po ashtu, këto OJQ nuk kanë dorëzuar raporte kthyesë financiare dhe narrative.

Shkak i kësaj ishte mos funksionimi i mirë i kontrolleve të brendshme, mungesa e zyrtarit monitorues, si dhe mos caktimi i një afati kohor të raportimit në kontratë.

Ndikimi

Thirrja publike për subvencionim të OJQ-ve në kundërshtim me rregulloren si dhe mos monitorimi i subvencioneve rrit rrezikun që mjetet buxhetore të ndahen dhe shpenzohen në kundërshtim me objektivat e komunës.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të siguroj që thirrjet publike për subvencionim të përmbajnë të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, pastaj të kërkoj nga OJQ-të të dorëzojnë raporte kthyesë financiare dhe narrative si dhe për çdo përfitues të subvencionit të caktojë zyrtar monitorues.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mungesa e planit vjetor për financimin publik të OJQ-ve

Gjetja

Sipas nenit 6 të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve (Plani Vjetor i Mbështetjes Financiare) kërkohet: “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit”.

Komuna nuk ka përcjellë planin vjetor për financim të OJQ-ve në ZKM, pasi që Drejtorit të cilat ofrojnë mbështetje financiare për OJQ-të, kishin dështuar në përgatitjen e planit vjetor.

Shkak i kësaj ishte neglizhenca e zyrtarëve kompetent për përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare.

Ndikimi

Mos përgatitja e planit vjetor rrit rrezikun që mjetet buxhetore të shfrytëzohen për qëllime tjera të paplanifikuara.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të siguroj se drejtoritë të cilat mbështesin financiarisht entitetet jo publike kanë përgatitur planin vjetor të mbështetjes financiare para miratimit të buxhetit vjetor. Në mbështetje të këtij plani fondet do të shpërndahen sipas prioriteteve dhe objektivave të caktuara për aktivitetet në fusha të caktuara me një kosto duke u respektuar parimi i efektivitetit dhe ekonomizimit për shpenzimet e krijuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,591,831€, prej tyre ishin shpenzuar 5,481,234€. Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, trotuareve, ndërtimin e objekteve, blerje të pajisjeve, automjete etj. Kemi testuar 48 mostra për teste substanciale në vlerë 3,709,069€, si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A6 - Mungesa e projekteve ekzekutive

Gjetja Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Tek aktiviteti i prokurimit për "Rregullimin e trotuareve në Vrellë", vlera e kontratës 48,894€ si dhe tek aktiviteti për "Mirembajtjen e objekteve të Administratës", vlera e kontratës 17,694€, komuna nuk kishte hartuar projekt ekzekutiv, por kishte iniciuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe paralogarinë.

Sipas zyrtarëve në mungesë të mjeteve financiare projektet ekzekutive hartohen vetëm në rastet kur kostoja e investimeve është më e lartë se kostoja e projektit.

Ndikimi Realizimi i investimeve kapitale pa projekte ekzekutive, rritë rrezikun e realizimit të punëve pa kritere standarde të ndërtimit (që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e shfrytëzuesve, mbrojtjen e ambientit, trashëgimisë dhe pronës) dhe vonesa në realizimin e tyre që mund të shoqërohen me kosto shtesë.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të siguroj kontrollë adekuate dhe të monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore që me rastin e kontraktimit të punëve duhet të hartohen paraprakisht projektet ekzekutive në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara të njësisë kërkuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PVF e pasurive kapitale është 111,960,249€, ndërsa pasuritë jokapitale dhe stoqet në PVF janë me vlerë zero. Rritja e vlerës së pasurisë kapitale krahasuar me vitin paraprak ishte rezultat i regjistrimit të tokave në pronësi komunale në vlerë prej 87,231,000€. Kemi testuar 67 mostra për teste substanciale në vlerë 3,800,377€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B4 - Mangësi në regjistrat kontabël të pasurisë

Gjetja

Bazuar në nenin 4.1 të rregullores MF-nr.02/2013-për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare. Ndërsa sipas neni 6.3 - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Neni 6 i rregullës MF nr.01/2017 për Raportimin vjetor financiar nga OB përcakton që - Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare.

Lidhur me këtë kemi indentifikuar se:

- Komuna ende nuk ka aprovuar rregulla dhe procedura të brendshme për evidencën ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë.
- Komuna kishte përdorë pjesërishtë programin e-pasuria për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë nën 1,000€. Rexhistri i e-pasurisë nuk është i saktë për arsye se blerjet nga sektori i QKMF-së, dhe sektori i Arsimit nuk regjistrohen në softuerin e e-pasurisë, siç është paraparë me rregulloren për menaxhimin e pasurisë Jo financiare.
- Vlera e pasurisë jo kapitale nën 1,000€ e prezantuar në PVF ishte nënvlerësuar për 248,696€ si dhe stoqet ishin nënvlerësuar për 53,179€. Në 11 raste¹⁰ pasuria jo kapitale nën 1,000€ në vlerë prej 13,490€ nuk ishte regjistruar në sistemin e-pasuria.

Shkak ishte neglizhenca dhe mungesa e angazhimit të zyrtarëve për të zbatuar kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Ndikimi

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton menaxhim të dobët të pasurisë, si pasoj ndikon në mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe në prezantimin jo të drejtë të pasurisë në pasqyra financiare.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat e pasurisë. Gjithashtu të sigurojë përdorimin e sistemit e-pasuria nëpër të gjitha drejtoritë si dhe të hartojë rregullore dhe procedura të brendshme për menaxhimin e pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.6 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 197,197€. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 31,482€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B5 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Komuna nuk ka arritur të përgatit një plan operativ për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe nuk ka ndërmarr veprimet e kërkuara sipas legjislacionit.

Llogaritë e arkëtueshme krahasuar me vitin e kaluar janë rritur në masën prej 16%, rritja më e madhe ka ndodhur te tatimi në pronë si dhe tek pronat e dhëna me qira.

Shkaqet e rritjes së të arkëtueshmeve janë veprimi i pamjaftueshëm i komunës, që përmes organeve të drejtësisë të zvogëlojë borxhin e pa mbledhur nga klientët.

Ndikimi Rreziku i mos arkëtimit të të hyrave ndikon në dëmtimin e buxhetit të komunës. Mungesa e kontrollit dhe mos veprimi i komunës pamundëson arkëtimin dhe rrit rrezikun e vjetërimit të llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve për rritjen e arkëtimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mblëdhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁹	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	14,011,426.00	15,356,369.20	13,665,096.38	11,298,092.68	9,542,939.93
Grante Qeveritare – Buxheti	10,310,128.00	10,754,133.39	9,897,883.88	9,047,397.40	8,568,226.42
Financimi përmes huamarrjes	0.00	94,520.00	92,580.00	0.00	0.00
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	2,550,000.00	2,550,000.00	2,402,274.99	1,018,849.34	0.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	589,483.58	426,372.69	357,315.76	135,405.69
Të hyrat vetanake	1,151,298.00	1,151,298.00	638,791.69	834,100.49	704,793.82
Donacionet vendore	0.00	41,282.52	31,544.60	40,429.69	15,060.00
Donacionet e jashtme	0.00	175,651.71	175,648.53	0.00	119,454.00

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,344,943€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak, rritjes së grantit qeveritar, donacioneve vendore dhe financimit nga huamarrja.

Në vitin 2020, komuna ka shpenzuar 89% të buxhetit final ose 13,665,096€, me një rritje prej 21% krahasuar me vitin 2019. Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	14,011,426.00	15,356,369.20	13,665,096.38	11,298,092.68	9,542,939.93
Pagat dhe mëditjet	6,078,347.00	6,239,661.94	6,211,772.77	5,932,592.45	5,861,876.32
Mallrat dhe shërbimet	1,345,525.00	1,893,599.97	1,482,802.63	1,164,195.27	904,245.22
Komunalitë	200,000.00	196,213.13	174,279.86	154,686.26	137,046.63
Subvencionet dhe transferet	260,000.00	435,063.06	315,007.55	328,610.41	251,783.88
Investimet Kapitale	5,366,878.00	6,591,830.54	5,481,233.57	3,718,008.29	2,387,987.88
Rezervat	760,676.00	0.56	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 161,315€ kjo rritje ishte rezultat i rishikimit të buxhetit në shumë prej 92,295€ i vendimeve të Qeverisë në shumë prej 69,020€. Ky buxhet ishte shpenzuar 100%.

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 548,075€, kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë në shumë prej 366,581€, rishikimit të buxhetit në shumë prej 171,494€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar në shume prej 10,000€. Përkundër rritjes realizimi i buxhetit final ishte 78% si rezultat i gjendjes pandemike COVID-19.

Buxheti final për shërbimet komunale në raport me buxhetin fillestar ishte me i ulët për 3,787€ si rezultat i i vendimeve të Qeverisë.

Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 175,063€, si rezultat i vendimeve të Qeverisë në shumë prej 70,063€ dhe të hyrave të bartura nga viti i kaluar në shume prej 105,000€ përkundër rritjes realizimi ishte 72%, si rezultat i gjendjes pandemike COVID-19.


Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,224,953€, kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë në shumë prej 526,003€ rishikimit të buxhetit në shumë prej 7,950€, të hyrave të batuara nga viti i kaluar në shume prej 475,000€ dhe granteve të përcaktuara të donatoreve në shumë 216,000€.

Buxheti final për rezerva në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 760,676€ buxhet i cili ishte transferuar në kategori tjera me vendime dhe rishikim të buxhetit.


Shpenzimet për menaxhimin e pandemisë COVID-19 të prezantuara në Pasqyra Financiare ishin në vlerë zero, kurse sipas auditimit ishin 560,830 si në vijim:

Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë shpenzuar 234,045€, për shtesa në pagë në kujdesin primar shëndetësor dhe inspeksion. Në kategorinë mallra dhe shërbime janë shpenzuar 266,784€, për pako ushqimore për familje, furnizime mjekësore, furnizime pastrimi etj. Ndërsa në kategorinë subvencione dhe transfere janë shpenzuar 60,000 për pagesa për përfituesit individual dhe subvencionim të entiteteve publike dhe jo publik

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Komuna për vitin 2020 kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 1,151,298€, nga të cilat ishin realizuar 787,307€ apo 68%. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	1,151,298.00	1,151,298.00	787,307.44	1,083,542.83	933,651.58
Të hyrat tatimore	495,169.00	495,169.00	299,467.92	395,940.40	320,677.44
Të hyrat jo tatimore	656,129.00	656,129.00	487,839.52	687,602.43	612,974.14

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Istogut ka rezultuar në 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu kishte bërë monitorim të zbatimit të rekomandimeve ku ishte përgatitur një raport monitorimi. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, tetë rekomandime janë zbatuar, dhe pesë rekomandime nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo nëse paraqitet nevoja të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore. Pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate. Gjithashtu obligime e bartura duhet buxhetohen me fondet të mjaftueshme me qëllim të forcimit të disiplinës financiare për pagesën me kohë dhe evitimin e ballafaqimit me drejtësinë duke eliminuar edhe pasojat apo mundësin e shpenzimeve shtesë	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorive përkatëse me zyrtaren kryesore për të hyrat kryhen në baza të rregullta mujore dhe të gjitha mospërputhjet e mundshëm të sqarohen me kohë.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj përditësimin e të dhënave në sistem duke paraqitur zonave tatimore krahas rregullores së aprovuar në kuvendin komunal	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe siguroj se prona komunale ofrohet për shfrytëzim vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave. Gjithashtu, duhet të shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e planifikuara do të realizohen.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Kryetari duhet të siguroj ndërprerjen e një praktike të tillë të angazhimeve dhe për pozitat e rregullta të punës për të cilat ka nevoja afatgjata kërkesat t'i adresoj me rastin e planifikimit buxhetor, dhe të njëjtat në vazhdimësi t'i trajtoj dhe diskutoj me MF. Ndërsa në rast të paraqitjes së nevojave për shërbime të veçanta apo punë specifike duhet të sigurojë se për marrëveshjet për shërbime të veçanta	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari të siguroj se drejtoritë të cilat mbështesin financiarisht entitetet jo publike kanë përgatitur planin vjetor të mbështetjes financiare para miratimit të buxhetit vjetor. Në mbështetje të këtij plani fondet do të shpërndahen sipas prioriteteve dhe objektivave të caktuara për aktivitetet në fusha të caktuara me një kosto duke u respektuar parimi i efektivitetit dhe ekonomizimit për shpenzimet e krijuara.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e Rekomandimeve	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroje se përcaktimi i saktë i nevojave dhe specifikimi i punëve duhet të përgatitet dhe projektohet para fillimit të tenderimit dhe në monitorimin e kontratave si organ mbikëqyrës, të përfshihet stafi kompetent që janë të njoftuar me përgjegjësit e përcaktuar me LPP. Nëse paraqitet nevoja për ndryshim të termeve dhe kushteve të kontratës, organi mbikëqyrës duhet të inicioj dhe arsyetoj pranë zyrës së prokurimit këto ndryshime e cila ka përgjegjësin për kontratën dhe marrin aprovimet nga nivelet relevante.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
8.	Investimet kapitale	Kryetari i komunës duhet të siguroj se njësitë kërkuese në bashkëpunim me zyrën e prokurimit bëjnë një analizë të	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste	I zbatuar

		detajuar të vlerësimit të nevojave që të arrihet shfrytëzimi sa më ekonomik i fondeve publike.	të tilla.	
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se bëhet planifikim i mirëfilltë i buxhetit, duke forcuar disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë dhe të marr masat e duhura për menaxhimin obligimeve për të evituar proceset gjyqësore të cilat bartin shpenzime shtesë.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë kontrollë shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetjake apo fonde tjera të financimit.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, të krijojë një sistem efikas të komunikimit dhe raportimit të të dhënave mes drejtorive dhe ZKF-së në mënyrë që informatat e shpalosura në PFV të jenë të sakta dhe të besueshme për përdoruesit dhe palët e jashtme, të funksionalizojë sistemin e-pasuria nëpër të gjitha drejtoritë si dhe të hartojë rregullore dhe procedura të brendshme për menaxhimin e pasurive. Të gjitha këto për menaxhim efektiv të pasurive me qëllim që regjistrat kontabël të paraqesin gjendjen reale të pasurive.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Llogaritë arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbauesve për rritjen e arkëtive.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Obligimet papaguara	Kryetari duhet të ndërmarrë masa shtesë të respektohet Rregulla financiare nr. 02/2013, që raportimi i detyrimeve të papaguara të bëhet në Thesar në baza mujore. Për më tepër të delegohet përgjegjësia të zyrtari i caktuar, i cili do të menaxhoj procesin që nga pranimi i faturës, protokolimin e saj dhe dorëzimi për ekzekutim (pagesë) ndaj furnitorit.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të shtoj kontrollët gjatë përgatitjes së PFV në mënyrë që tabelat dhe shpalosjet për vitin 2021 të mos përmbajnë gabime. Po ashtu, duhet të sigurohet se deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk nënshkruhet nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollët e nevojshme sipas draft PVF-ve.
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të ngritë kontrollë shtesë për tu siguruar se të gjitha faturat e pranuaru paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të

		obligimeve të papaguara.
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj që gjatë subvencionimit të respektohen rregulloret në fuqi, gjithashtu duhet të inicioj procedura për vendosjen e kriterëve për vlerësimin e kërkesave dhe ndarjen e subvencioneve për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.
4.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.
5.	Të hyrat	Kryetari të siguroj se prona komunale ofrohet për shfrytëzim vetëm me procedura të ankandit publik. Gjithashtu, duhet të ndërmerr veprime ligjore përmes përmbauesve dhe gjykatës për mbledhjen e borxheve si dhe të formoj një komision i cili do të verifikoj të të rastet e shlyerjes së borxheve.
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se dosjet e tatimpaguesve janë kompletuar bazuar në kërkesat e sistemit Protax.
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari të siguroj se drejtoritë të cilat mbështesin financiarisht entitetet jo publike kanë përgatitur planin vjetor të mbështetjes financiare para miratimit të buxhetit vjetor. Në mbështetje të këtij plani fondet do të shpërndahen sipas prioriteteve dhe objektivave të caktuara për aktivitetet në fusha të caktuara me një kosto duke u respektuar parimi i efektivitetit dhe ekonomizimit për shpenzimet e krijuara.
8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që thirrjet publike për subvencionim të përmbajë të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, pastaj të kerkoj nga OJQ-të të dorzojnë raporte kthyesë financiare dhe narrative si dhe për çdo përfitues të subvencionit të caktojë zyrtar monitorues.
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore që me rastin e kontraktimit të punëve duhet të hartohen paraprakisht projektet ekzekutive në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara të njësisë kërkuese.
10.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat e pasurisë. Gjithashtu të sigurojë përdorimin e sistemin e-pasuria nëpër të gjitha drejtoritë si dhe të hartojë rregullore dhe procedura të brendshme për menaxhimin e pasurive.
11.	Llogaritë arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbauesve për rritjen e arkëtimeve.

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndhimëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Udhëheqës i Auditimit



Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit



Hysen Restelica, Anëtar i ekipit



Arian Zenelaj, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Nga mostrat e testuar dhe analiza e bazës së shënimeve të Protax-it, kemi konstatuar se numri i tatimpaguesve që përfitojnë nga zbritja pa e pasur dosjen e kompletuar është 1,237, ku 608 prej tyre nuk kanë të vendosur numrin e letërnjoftimi ndërsa 629 kanë të vendosur numra që nuk korrespondojnë me numër të letërnjoftimit të Republikës së Kosovës.</p>	<p>Ne sistemin e Tatimit ne Prone, tatimpagues qe posedojne objekte banimi, afarizmi dhe industriale per vitin 2020, e qe nuk kane nr. personal gjithesejt jane 1.005 raste, ose shprehur ne perqindje jane 7%. Ne kete drejtim qendrojme shume mire, dhe ate mbi mesataren ne tere Republikes se Kosoves.- Tatimpaguesit qe nuk kane shtetesi te Kosoves , as nr.personal te Kosoves, por qe kane pasuri te patundeshme dhe paguajne obligimet tatimore ne venlindje, atyre sistemi i Tatimit ne Prone, ju mundeson regjistrimin e nr.personal te shteteve ku jetojne. - Tatimpaguesit qe nuk posedojne fare nr.personal, ne sistem u vendoset, nje numer 10 shifror, zakonisht 10 zero. Ndryshe nuk printohet fatura per pagese, as Vertetimi nga sistemi.-Kriteret dhe rregullat per zbritje ne venbanimin primar i cakton dhe i zbaton ne nivel vendi DTP-Prishtine, ne çdo fillim viti kalendarik. JO ZTP.-ZTP, ne vazhdimesi punon qe tatimpagueseve tu regjistrohet nr.personal ne sistem. Kuptohet kur ata i posedojne.</p>	<p>Komuna ka dhënë vetëm sqarime lidhur me gjendjen e përgjithshme të funksionimit të sistemit të tatimit në pronë, mirëpo nuk ka kundërshtuar të gjeturën dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me sqarimin e dhënë, prandaj e gjetura qëndron.</p>
<p>Komuna nuk ka prezentuar sakt të thënat në PVF si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> Tek neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit-hyrjet e parasë së gatshme - shënimi 11 - grantet e përcaktuara të donatorëve ish-in mbivlerësuar për 205,000€, ku të prezantuar në PVF ish-in 216,000€, ndërsa sipas shënimeve të thesarit vlera e saktë e tyre ishte 11,000€. Po ashtu, tek shënimi 12 të hyrat tjera ish-in mbivlerësuar për 93,000€, ku sipas shënimeve të thesarit vlera e tyre ishte zero. 	<p>Siqe jeni te informuar,per arsyet e voneses se dorezimit te PFV 2020 ne MFPT-DPTH,nga OB-Komuna e Istogut. DPTH,na ka mundesuar qe PFV 2020 ti dorezojme me vonese(12.03.2021)Ne nuk kemi mundur ti regjistrojme disa te dhena me kohe ne PFV 2020,ne veqanti ,Obligimet e Arketueshme nga Tatimi ne Prone,(1,277,382€)ku Softwari i TP ne ato dite nuk na jepte mundesi te i nxjerrim te dhenat e duhura,Para se te filloje Auditimi nga Auditoret e ZKA,ne i kemi korigjuar PFV 2020,por nuk i kemi derguar ne MFPT-</p>	<p>Komuna ka dhënë vetëm sqarime sa i përket shkakut të mos korigjimit të PVF-ve, prandaj e gjetura qëndron.</p>

<ul style="list-style-type: none"> • Tek neni 16 -Të arkëtueshmet ishin nënvlerësuar për 1,290,922€, pasi që nuk ishin prezantuar fare të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë 1,277,382€ dhe qeraja e tokës komunale me karakter të përkohshëm në vlerë 13,540€. 	<p>DPTH te korigjuara,duke e ditur qe i kemi dorezuar me vonese.Ne konsulte me Auditoret e ZKA,qe benin Auditimin,u dakorduam qe te bejme nje Shkrese DPTH ,qe te na mundesoje pranimin PFV te korigjuara per vitin fiskal 2020.Kerkesa e pare eshte bere me date 27.05.2021,nuk kemi marre pergjigje, me rekomandimet e Auditoreve qe te perseritet kerkesa prape 07.07.2021, ku nuk kemi mar pergjigje deri me daten 19.07.2021 nga zevendes Drejtori per Raportime z.Koca, DPTH, ku na eshte refuzuar kerkesa per pranimin e Pasqyrave Financiare te Korigjuara Duke u bazuar ne arsyetimet e lartecekura.</p> <p>-Kerkojme qe si pase mundesive ligjore ,te permiresohet,Opinionit i Auditoreve te ZKA,ne Draft Raportin per OB-Komuna e Istogut per vitin fiskal 2020,te derguar me date 19.07.2021.</p>	
---	---	--



Komuna -Istog

Opstina -Istok

Istog Municipality

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Istogut, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe (Pajtohem/ Pjesërisht, te Cështja A1 dhe Cështja A4, kemi dhënë sqarime në Tabelën për Komentet, në Cështjet dhe Rekomandimet e Auditorve të ZKA për OB-Komuna Istog)
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

ZKA-Kryetar i Komunës

, Z. Haki Rugova, Nënshkrimi

Data: 02 Gusht 2021



REPUBLIKA E KOSOVËS
NË PUSHTIM KOSOVO
DREKTORIA E ADMINISTRATËS PËR PËRMBYRTËSI
SHËRBËJA QYRTË ADMINISTRATIVE
ISTOG
Nr: 01-UMG-30226 Data: 04.08.2021
Bj: Datum
ISTOG-ISTOK

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁰ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹¹ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. Opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen (t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionit i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(ve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- 1 Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- 2 Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- 3 Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- 4 Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- 5 #633200865 PDB-NDERTIMI I SKEMES PER FURNIZIM ME UJE NE KOMUNEN E ISTOGUT,Contract.01-400-41356 date 29.08.201, vlera 246,589.28€; #633200865 PDB-NDERTIMI I SKEMES PER FURNIZIM ME UJE NE KOMUNEN E ISTOGUT,Contract.01-400-41356 date 29.08.2017, vlera 458,734.83€,#633200865 PDB-NDERTIMI I SKEMES PER FURNIZIM ME UJE NE KOMUNEN E ISTOGUT,Contract.01-400-41356 date 29.08.2017
- 6 Uji në vlerë 20,000€; Sanimi i gjendjes nga fatkeqësitë natyrore në vlera 20,038€; Sanimi i gjendjes nga fatkeqësitë natyrore në vlera 7,175€; Projekt me bashkëfinancim në vlerë 5,000€. Furnizimi i klubeve me rekuizita sportive në vlerë 15,000.00€ dhe Furnizimi me pako higjienike për familje skamnore në vlerë 9,531.90€ dhe 2,756.16€.
- 7 1.1. Udhëzimet e thirrjes për aplikantët, duke përfshirë kriteret për përzgjedhjen e përfituesve; 1.2. Formularin për përshkrimin e projektit/programit; 1.3. Formularin e buxhetit; 1.4. Listën e plotë të dokumenteve të nevojshëm për t'u paraqitur në thirrje; 1.5. Datën e hapjes dhe mbylljes së thirrjes; 1.6. të dhëna për mënyrën e dorëzimit të aplikacioneve; dhe 1.7. të dhëna për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes dhe kontraktimit.
- 8 #633201458 MOBILJE, vlera 1,430€; #633202950 MOBILJE,KARRIGA, vlera 525€; #633202396 MOBILJE, vlera 3,630€; #633203094 FURNIZIM I SHKOLLES ME INVENTOR, vlera 2,295€; #633203001 MOBILJE, vlera 590€; #633202406 MOBILJE PER ZYRE, vlera 1,800€; #633200945 KOMPJUTERË, vlera 500€; #633200188 MBYLLJA E AVANSIT PETTY CASH 2020-21982, vlera 20€; #633201186 PAISJE TË NDRYSHME PËR QKMF, vlera 985€, #633200275 PAISJE,GJENERATOR, vlera 965€; #633200321 PAISJE GJENERATOR, vlera 750€.
- 9 Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- 10 Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- 11 Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.